



Eficienca e buxhetit të Bashkisë Elbasan (Viti 2019)

1. Analiza e parashikimit të të ardhurave për vitin fiskal 2019

Studimi ka për qëllim të analizojë eficiencën dhe shpenzimet e të ardhurave për vitin 2019, e cila do të na ndihmojë të shohim se ku janë përfitimet, problematikat dhe pritshmëritë.

Projekti financohet nga UNDEF dhe zbatohet nga ARZH (Agjensia Rajonale e Zhvillimit) dhe EIC (Economic Intelligence Center) Korçë.

Bazuar në Ligjin nr. 9632, “Për sistemin e taksave vendore”, bashkitë kanë të drejtë të vendosin taksat e tyre +/- 30% nga taksa e miratuar në Ligj, ndërsa tarifatat mund të rriten, zvogëlohen, shtohen apo hiqen me miratim të Këshillit Bashkiak, sipas nevojave të Bashkisë. Ndërsa transfertat janë fonde, të cilat u delegohen bashkive sipas parashikimeve ligjore dhe funksioneve shtesë që mori pushteti vendor nga Reforma Administrative Territoriale.


Më poshtë jepen të ardhurat totale të bashkisë:

Tabela 1. Të ardhurat totale të Bashkisë sipas burimeve

| Burimet e financimit | (Vlera në 000 Lekë) | (Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë | % mbi totalin e të ardhurave |
|--|---------------------|---|------------------------------|
| Transferta e pakushtëzuar (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të lirë) | 673,776 | 6,541,515 | 28% |
| Transferta e pakushtëzuar sektoriale (fondi i deleguar nga Qeveria në funksion të Bashkive për përdorim të përcaktuar) | 413,440 | 4,013,981 | 17% |
| Të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore (të ardhurat nga detyrimet e qytetarëve kundrejt Bashkisë) | 1,030,434 | 10,004,214 | 43% |
| Të ardhura të tjera (të ardhura nga institucionet që Bashkia ka nën varësinë e saj) | 277,829 | 2,697,369 | 12% |
| TOTALI | 2,395,479 | 23,257,078 | 100% |

Burimi: Bashkia Elbasan (llogaritje EIC)

Figura 1. Të ardhurat totale, Bashkia Elbasan 2019



Burimi: Bashkia Elbasan (llogaritje EIC)

2. Analiza e shpenzimeve të Bashkisë Elbasan për vitin fiskal 2019

E rëndësishme për qytetarët është procesi i shpërndarjes së fondeve, ose e thënë ndryshe, ku shkojnë paratë e taksapaguesve; përse shpenzohen nga bashkia?


Analiza më poshtë do marrë në konsideratë shpenzimet afatshkurtra dhe ato afatgjata për vitin 2019. Më poshtë po japim tabelën përmbledhëse të shpenzimeve:

Tabela 1. Shpenzimet totale të Bashkisë sipas programeve dhe raporti mbi të ardhurat totale

| Emërtimi i shpenzimit | (Vlera në 000 Lekë) | (Vlera në Dollarë) Kursi i këmbimit 1 \$ = 103 Lekë | % mbi totalin e të ardhurave |
|------------------------------|---------------------|---|------------------------------|
| Shpenzime Paga+Sig.Shoqërore | 621,913 | 6,037,990 | 26 |
| Shpenzime Korrente | 860,819 | 8,357,466 | 36 |
| Shpenzime për Investime | 769,144 | 7,467,417 | 32 |
| TOTALI | 2,251,876 | 21,862,874 | 94 |


Burimi: Bashkia Elbasan (llogaritje EIC)

Figura 2. Shpenzimet totale si raport mbi të ardhurat totale në %



Burimi: Bashkia Elbasan (llogaritje EIC)

Figura 3. Shpenzimet për paga/sig. shoqërore si raport mbi të ardhurat lokale



Burimi: Bashkia Elbasan (llogaritje EIC)